



**PROCESVERBAL**  
**Nga mbledhja e jashtëzakonshme e (VIII-të për v. 2011) e**  
**Kuvendit Komunal në Vushtrri mbajtur më 12.9.2011**

Mbledhja u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal duke filluar në orën **10:10**.

Në këtë mbledhje përveç Besim Jasharit, ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: Bajram Mulaku, kryetar i Komunës, Dibran Përçuku, nënkryetar i Komunës, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të ICO (Zyra Civile Ndërkombëtare), dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit, i cili konstatoi se ka kuorum për punë.

**Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit-** tha se arsyeja pse është thirrur seanca e jashtëzakonshme është se Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës vendim për këtë vit lidhur me ridestinimin e mjeteve të mbetura nga projektet për t'i destinuar në projektet tjera të aprovuara nga kuvendi komunal. Kurse lidhur me pikën nr. 2 të rendit të ditës, tha se banorët e tre fshatrave kanë bërë petitionet për të kundërshtuar transferimin e nxënësve në shkollat amë.

**Pajazit Pllana, anëtar i Kuvendit-** pyeti se cilat janë mjetet që ndahen nga grantet prej Qeverisë së Kosovës, dhe cilat janë mjetet që duhet të ridestinohen prej të hyrave vetanake, duke shtuar se në materialin për këtë pikë të rendit të ditës del se në fshatin Shtitaricë nuk ka fare asfalt të shtruar, kurse në fshatrat tjera të Komunës së Vushtrrisë janë bërë edhe degëzimet e asfaltuara, prandaj kërkoi sqarim se si janë ridestinuuar mjetet.

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës-** lidhur me procedimin e pikës nr. 1 të rendit të ditës, tha se vitin e kaluar kryetari i komunës është autorizuar që mjetet e lira t'i ridestinojë në projekte të ndryshme, kurse vendimi i vitit të kaluar është akoma valid, mirëpo në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave ka paraqitur pengesë me arsyetimin se vendimi është i vitit të kaluar, dhe nuk mund të shfrytëzohet për këtë vit, prandaj për të mos humbur në kohë, është dashtë të thirret seanca e jashtëzakonshme. Kurse lidhur me pyetjen nga anëtari i kuvendit, tha se rrugët e fshatit Shtitaricë janë të planifikuara nga të hyrat vetanake, duke shtuar se nëse në këtë vit nuk hyn, vitin tjetër gjithsesi do të realizohet edhe ai projekt.

**Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit-** tha se pajtohet me ridestinimin, por ngriti shqetësimin lidhur me nevojën e rregullimit të trotuarit për nxënësit që do të lidhte fshatrat nga Vushtrria në drejtim të Bukoshit dhe të Novolanit, pasi që aty rrezikohen nxënësit për çdo ditë, kur vijnë në shkollat e qytetit. Pastaj ka qenë në prioritet edhe

rruga që lidh fshatin Kollë me magjistralen Vushtrri – Duboc, dhe shtoi se edhe pse është në projekt, siç duket nuk është ndërmarrë asgjë në këtë drejtim, prandaj është mirë që çështja e buxhetit të balancohet në mënyrë të drejtë në të gjitha fshatrat e komunës tonë, pa pasur prioritete të veçanta dhe kahje partiake, pasi që ka fshatra që janë të izoluar tërësisht me kilometra të tëra.

**Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi në mënyrë unanime aprovoi këtë:**

## R E N D I T E

**1. Shqyrtimi i propozimit për ridestinimin dhe transferimin e mjeteve të lira buxhetore të mbetura nga projektet e realizuara në vitin 2011.**

**2. Shqyrtimi i peticionit të banorëve të fshatrave: Studime e Epërme, Beçuk dhe Karaçë.**

**1. Shqyrtimi i propozimit për ridestinimin dhe transferimin e mjeteve të lira buxhetore të mbetura nga projektet e realizuara në vitin 2011.**

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës-** paraqiti sqarime shtesë lidhur me mjetet që do të transferohen dhe ridestinohen për realizimin e projekteve të caktuara.

**Ismet Gashi, anëtar i Kuvendit-** në emër të Grupit parlamentar të LDK-së pajtohet me propozimet në fjalë, por kur të vijnë në seancë të kuvendit është mirë t'iu bashkëngjitet një specifikacion (paramasë, paralogari) se çka do të punohet, duke shtuar se për rr. "Hamit Hyseni" në seancën e prillit janë ndarë mbi 70.000 € për ndërtimin e kësaj rruge, dhe përsëri kërkohen edhe 40.835 €, prandaj do të ishte mirë që anëtarët e kuvendit të kenë njohuri përmes specifikacionit se çka është punuar, çka ka mbetur pa u punuar, dhe pse po kërkohet kjo shumë shtesë, duke shtuar se ka shumë projekte që kanë mbetur në gjysmë, dhe përmendi udhëkryqin te Memoriali i Dëshmorëve, ku shpesh rrezikohen nxënësit tanë nga shoferët e pandërgjegjshëm, dhe pyeti pse nuk po mendohet që të vendoset një shenjë e cila tregon se aty afër është shkolla, dhe të vendosen edhe zebrat për kalim të udhëtarëve.

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës-** tha se rr. "Hamit Hyseni" ka përfunduar me paramasat që i ka pas, por mjetet që kanë qenë të destinuara nuk kanë lejuar për të përfunduar të gjitha detajet ashtu siç është planifikuar ndërtimi i kësaj rruge me trotuar, me sinjalizime dhe me disa kanalizime të ujërave atmosferike. Mandej tha se është realizuar një projekt i mirë edhe me trotuare, megjithëse nuk janë përfshirë trotuaret në rrugë që lidhen me të njëjtën rrugë. Gjithashtu njoftoi se në tërë rrugën do të ketë ndriçime, dhe do të ndërtohen edhe disa parkingje.

**Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit-** në emër të Grupit parlamentar të AAK-së e përkrahu ridestinimin dhe transferin e mjeteve për realizimin e projekteve që kanë mbetur të papërfunduara, dhe propozoi vazhdimin e punimeve për të finalizuar rrugën "Haxhi Zeka" duke e vazhduar deri në dalje të qytetit, dhe në këtë mënyrë do të lirohej shumë rr. "Skënderbeu", dhe do të kishte më pak incidente, pasi që ka shumë incidente të shkolla fillore "Mustafë Venhari". Mandej tha se janë dy kërkesa të qytetarëve për rregullim e lumit "Studime", dhe kërkesa tjetër është për rregullimin e lumit "Podrança", pasi që ka shumë kundërmime dhe mbeturina, prandaj kërkoi që të kihen parasysh këto propozime.

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës-** tha se rr. "Haxhi Zeka" ka qenë e planifikuar për t'u rregulluar edhe me participimin e qytetarëve, dhe kërkesa që iu është bërë Ministrisë së Pushtetit Lokal, e njëjta ministri ka premtuar që do t'i kemi në bashkëfinancim 200.000 €, dhe kjo shumë na mjaftonte për t'i realizuar të gjitha projektet e planifikuara për realizim. Mirëpo ministria në fjalë i kishte tërhequr 100.000 €, mirëpo nuk përjashtoi mundësinë që me mjete të këtij viti të realizohet edhe projekti në fjalë. Gjithashtu, tha se në planifikim për vitin e ardhshëm është

paraprarë edhe rr. Haxhi Zeka. Kurse sa i përket lumit "Studime", tha se është planifikuar që vitin e ardhshëm fillimisht të shtrihet rrjeti i kanalizimit për ujërat fekale.

**Veli Karaça, anëtar i Kuvendit-** tha se e mbështet ridestinimin e mjeteve për realizimin e projekteve në fjalë, kurse tha se qyteti i Vushtrrisë nuk ka shumë parqe, e ka vetëm një park, dhe ai është në gjendje të mjerueshme, por në parkun e qytetit është investuar disa herë duke e meremetuar, dhe kemi punësuar një punëtor për mirëmbajtjen e parkut, prandaj para se të investojmë në park, duhet të ngritet përgjegjësia për ruajtjen e parkut.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i Kuvendit-** Grupi parlamentar i PDK-së e mbështet propozim-vendimin në fjalë.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

*Mjetet e lira në programin (18024) Drejtoria për Shërbime Publike, projekti "ndërtimi i urës mbi lumin Sitnicë", kodi i projektit 83449, fondi burimor (10) të bëhet transferi i mjeteve në shumën prej 24.881.86 €, në programin (47024) Drejtoria për Bujqësi, Ekonomi dhe Zhvillim Rural, në projektin "ndërtimi, asfaltimi i rrugëve me infrastrukturë përcjellëse", kodi 83132.*

*Mjetet e lira në programin (16324) Drejtoria për Administratë dhe Personel, projekti (furnizimi me kamera të komunës), kodi i projektit 83120, fondi burimor (21) të bëhet transferi i mjeteve në shumën prej 4.314.42 € në programin (47024) Drejtoria për Bujqësi, Ekonomi dhe Zhvillim Rural, në projektin "ndërtimi, asfaltimi i rrugëve me infrastrukturë përcjellëse", kodi 83132.*

*Mjetet e lira në programin (18024) Drejtoria për Shërbime Publike, projekti "ndërtimi i urës mbi lumin Sitnicë", kodi i projektit 83449, fondi burimor (10) të bëhet ridestinimi i mjeteve në shumën prej 40.835.50 €, për realizimin e projektit të ri "rregullimi i infrastrukturës në rr. Hamit Hyseni".*

*Me këtë vendim Kuvendi i Komunës ia delegon përgjegjësitë kryetarit të Komunës për marrje të vendimeve për ridestinim, përkatësisht shfrytëzim të mjeteve të lira të mbetura nga projektet e realizuara, në projekte tjera të planifikuara me vendim të kuvendit të komunës për vitin 2011.*

## **2. Shqyrtimi i petitionit të banorëve të fshatrave: Studime e Epërme, Beçuk dhe Karaçë.**

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës-** sqaroi se në seancën e fundit, kuvendi ka marrë vendim që nga tri shkollat: Studime e Epërme, Karaçë dhe Beçuk nxënësit të zhvendosen nga paralelet e ndara për shkak të kushteve jo të mira dhe numrit të vogël të tyre, prandaj është vendosur të transferohen në shkollat amë. Mirëpo, ka ardhur një reagim i prindërve dhe i disa qytetarëve për vendimin që ka marrë kuvendi, prandaj edhe i kanë sjellë këto tri peticione. Në vazhdim tha se kuvendi ka marrë një vendim të drejtë, pasi që me këtë vendim është synuar që të dominojë cilësia në mësim, dhe fakti që kemi asfaltuar rrugët na ndihmon për të transportuar nxënësit. Në fund tha se nëse vendoset rikthimi i nxënësve në paralelet e ndara në tri shkollat në fjalë, përgjegjësinë për cilësinë në mësim e bartin arsimtarët, duke shtuar se nuk mund të ketë punë të mirëfilltë me paralele të kombinuara.

**Refik Ramaj, anëtar i Kuvendit-** tha se Grupi parlamentar i LDK-së mbështet kërkesat e qytetarëve që të revidohet vendimi nga seanca e kaluar e kuvendit, dhe të vazhdohet si në të kaluarën, derisa prindërit dhe nxënësit të binden se nuk është në funksion të cilësisë.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i Kuvendit-** Grupi parlamentar i PDK-së e merr me shumë seriozitet situatën e krijuar në Studime të Epërme, Karaçë dhe Beçuk. Pastaj tha se vendimi i marrë në seancën e kaluar nuk ka qenë vendim i gabuar, sepse është menduar për një cilësi më të mirë në arsim, duke shtuar se në tri vitet e fundit Qeveria e Kosovës së bashku me kuvendin komunal ka bërë investime të

jashtëzakonshme në tërë territorin e Komunës së Vushtrrisë, në veçanti në rajonin ku ekzistojnë shkollat e sipër përmendura, mirëpo duke pas parasysh vullnetin e prindërve të këtyre nxënësve që mësimi të vijojë në ato shkolla, Grupi parlamentar i PDK-së përkrah vullnetin e prindërve që mësimi të vazhdojë në ato shkolla ku është mësuar deri tani. Gjithashtu, kërkojmë nga qeveria komunale të ndajë mjete për renovimin e shkollave në fjalë dhe të sigurojë staf të mjaftueshëm dhe adekuat për zhvillimin e procesit mësimor.

**Muharrem Shabani, anëtar i Kuvendit-** tha se Grupi parlamentar i AAK-së edhe mbledhjen e kaluar ka qenë kundër vendimit të tillë, pasi që nuk ka qenë një procedurë e përgatitur, transparente, dhe nuk është bërë një analizë rreth kësaj çështjeje, dhe vetëm me një akt (shkresë) pa formë dhe pa procedurë është kërkuar mbyllja e shkollave në fjalë, prandaj kemi vlerësuar se nuk është çështje serioze. Pastaj tha se nëse bëhen përgatitjet me kohë, në mënyrë analitike dhe të gjithanshme, mund të merret një vendim i arsyeshëm. Në fund kërkoi që të anulohet vendimi i seancës së kaluar, të shtyhet për një periudhë, të bëhen përgatitjet e duhura dhe të bisedohet në mënyrë analitike dhe të gjithanshme me prindërit.

**Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit-** tha se nuk ka qenë në pyetje një akt, por një vendim i kuvendit, dhe qëllimi ka qenë shumë i mirë për të ngritur cilësinë në mësim, por qëllimi edhe më i mirë është nëse përfillim vullnetin e qytetarëve, dhe përkrahu rikthimin e gjendjes së mëparshme, por me një ngritje të cilësisë, me një përkushtim shumë më të madh, dhe kontroll më rigoroz në ato tri shkolla.

**Veli Karaça, anëtar i Kuvendit-** tha se e çmon angazhimin e qeverisë komunale për të siguruar cilësi të mirë në arsim, mirëpo duhet respektuar vullnetin e qytetarëve që nxënësit të mos transportohen në shkollat tjera. Pastaj paraqiti një kërkesë për nxënësit e klasëve VI – IX të ketë një kontroll më të mirë nga Drejtoria për Arsim për mënyrën e transportimit, pasi që transporti i tyre duhet të jetë i veçantë, dhe të mos bëhet së bashku me udhëtarët tjerë. Gjithashtu tha se nëse nuk ka pagesë të mirë për transportimin e nxënësve, nuk ka as cilësi të mirë dhe as siguri, kurse siguria duhet të jetë mbi të gjitha. Ndërsa lidhur me cilësinë, tha se cilësi e nevojshme mund të sigurohet edhe nëpër këto shkolla, përmes një përkushtimi më të madh të mësimit, dhe një kontrolli dhe monitorimi më të mirë të Drejtorisë për Arsim.

**Sabit Kadriu, anëtar i Kuvendit-** duke iu referuar vendimit për transferimin e nxënësve nga tri fshatrat nga paralelet e ndara në shkollat amë, tha se është për t'u habitur se si i kanë ndërruar mendimet anëtarët e kuvendit nga seanca e kaluar. Pastaj tha se procedura e marrjes së vendimit ka qenë e rregullt, dhe shtoi se atë ditë kemi qenë dakord se nuk mund të funksionojnë tri shkolla me 60 nxënës. Pastaj tha se nuk ka kualitet në mësim me 5 – 6 nxënës dhe me paralele të kombinuara. Gjithashtu, tha se askush nuk po i mbyll shkollat, por nxënësve po iu ofrohet cilësi në mësim, dhe se askush nuk është fajtor, as komuna nuk është fajtorë që po vjen deri te pakësimi i nxënësve. Prandaj nëse kërkohet cilësi në mësim, nuk është problem të organizohet transportimi i nxënësve të paraleleve të ndara në fjalë. Mandej kërkoi që transportuesit e nxënësve duhet ta respektojnë orarin e mësimit të nxënësve dhe të vendosin në kombibusët e tyre shenjën që tregon se janë duke bartur nxënës. Në fund tha se ekziston Rregullorja e arsimit që përcakton numrin e nxënësve për të formuar një paralele.

**Habib Mustafa, anëtar i Kuvendit-** tha se i përkrah petitionet e bëra nga prindërit, dhe duhet rikthyer gjendja e mëparshme. Duke iu referuar vërejtjes së bërë lidhur me numrin e vogël të nxënësve, tha se numri i nxënësve që duhet të jetë minimum 21 nxënës për t'u ndarë nëpër paralele, vlen për qytet dhe për shkolla të mëdha, ndërsa për vendet rurale, për vendet ku nuk ka nxënës të mjaftueshëm, numri i nxënësve ndryshon. Pastaj tha se përveç që duhet rikthyer gjendja e mëparshme, duhet të mos kombinohen paralelet, aty ku ka mundësi. Gjithashtu njoftoi se ka marrë një të dhënë nga drejtoria e shkollës në fshatin Beçuk ku janë të evidentuar 37

nxënës që këtë vit vijojnë shkollimin deri në klasën e IV-të, prandaj sipas Udhëzimit Administrativ duhet të jenë 4 klasë të kombinuara, e jo 2 klasë.

**Qazim Azemi, anëtar i Kuvendit-** tha se jemi në shërbim të qytetarëve, dhe është mirë që ka ndryshuar mendimi, dhe po respektohen petitionet e qytetarëve. Pastaj tha se edhe në seancën e kaluar e kemi kundërshtuar marrjen e vendimit për transferim të nxënësve në shkollat amë, pasi që vendimi ka qenë i papërgatitur dhe i ngutshëm, dhe ai vendim nuk ka kaluar përmes KPF-së dhe Komitetit Konsultativ për Arsim, por as nuk është bërë debat me qytetarë lidhur me çështjen në fjalë. Pastaj tha se ka shkollë që ka vetëm 2 nxënës, por nuk është mbyllur. Në fund tha se akoma nuk janë krijuar kushtet që të merret vendim për transferimin e tillë në shkollat amë.

**Xhylsime Feka, anëtare e Kuvendit-** tha se nuk është marrë asnjë vendim për t'u ndërprerë mësimi, por është marrë vendim që të transferohen nxënësit në shkollat amë, pasi që në paralelet e ndara nuk ka kushte adekuate për zhvillim cilësor të procesit mësimor.

**Qerim Selimi, drejtor i Drejtorisë për Arsim-** lidhur me faktin që ka shkolla me numër edhe më të vogël të nxënësve, siç janë: Kurillova, Gumnishta, por që akoma funksionojnë, tha se arsyeja pse këto shkolla funksionojnë është mungesa e infrastrukturës rrugore që pamundëson transferimin e këtyre nxënësve. Pastaj tha se qëllimi i vendimit për transferimin e nxënësve ka qenë për të mirën e tyre. Gjithashtu premtoi se do të kontrollohen edhe vijat transportuese të nxënësve, dhe do ta shqyrtojmë edhe mundësinë e ngritjes së çmimit për transportimin e nxënësve, nëse kjo ndikon në transportimin cilësor, dhe bashkarisht do të punojmë në ngritjen e cilësisë. Kurse lidhur me numrin e nxënësve në shkollën Beçuk, tha se nuk është numri 37 i nxënësve, por në bazë të dhënave nga drejtori i shkollës janë 28 nxënës. Në fund tha se edhe në këto shkolla ku do të zhvillohet mësimi, do të angazhohemi për të ngritur cilësi, ose duke i ndarë nëpër klasë të veçanta dhe të zvogëlohet ora mësimore, ose duke angazhuar staf të ri.

**Bajram Mulaku, kryetar i Komunës-** tha se propozimi për transferimin e nxënësve në shkollat amë ka qenë propozim i drejtë dhe qëllim-mirë për ngritjen e cilësisë së mësimit për nxënësit e tri shkollave të fshatrave në fjalë. Pastaj tha se në seancën e kaluar, kuvendi komunal e ka peshuar shumë seriozisht dhe profesionalisht kërkesën e Drejtorisë për Arsim për transferimin e nxënësve në fjalë dhe ka marrë vendim të qëndrueshëm. Gjithashtu tha se nuk ka ndodhur mbyllje e shkollave, por është bërë transferimi i nxënësve nga paralelet e ndara në shkollat amë. Mandej tha se edhe në këto kushte duhet bërë përpjekje që t'iu ofrohen kushte për mësim cilësor, duke shtuar se në shkollën e Karaçës duhet ndërhyrë urgjentisht për të krijuar kushte për mësim, pasi që nuk ka kushte të zhvillohet procesi mësimor gjatë sezonës së dimrit.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 25 vota "për", 4 "kundër", të tjerët "abstenim" vendosi me sa vijon:**

***Aprovohen petitionet e fshatrave: Studime e Epërme, Beçuk dhe Karaçë për anulimin e vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr.161/11, dt. 28.07.2011.***

***Obligohet Drejtoria për Arsim në Vushtrri që të rikthen nxënësit e fshatrave të cekur në nenin 1 të këtij vendimi, nga shkollat amë në paralelet e ndara të shkollave, në të cilat është zhvilluar procesi mësimor më parë.***

**Mbledhja përfundoi në orën 11:15.**

**Procesmbajtësi:  
Albanez Tahiraj**

**Kryesuesi i Kuvendit  
Ferit Idrizi**

**Lektore:  
Vlora Krasniqi**